1. Personat fizik regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, si dhe një kopje të dokumentit të identifikimit. 2. Shoqëritë e Thjeshta regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, kontratën përkatëse sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe kopje të dokumenteve të identifikimit të anëtarëve. Në rast se palët nuk kanë lidhur kontratë me shkrim, regjistrimi i shoqërisë së thjeshte mund të kryhet duke depozituar vetëm aplikimin e plotësuar në të gjitha të dhënat e detyrueshme, kopje të dokumenteve të identifikimit, dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e shoqërisë së thjeshte. 3. Shoqëritë Tregtare regjistrohen në Regjistrin Tregtar duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast së janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin sipas legjislacionit në fuqi. 4. Shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi te kufizuar, mund të regjistrohen gjithashtu duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve, dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me organizimin dhe	initial registration completed with all the required data in accordance with the present Law, as well as a copy of the identification document. 2. Simple partnerships register by filing the application for the initial registration, completed with all the required data in accordance with this law, the relevant contract as provided by the Civil Code and copy of the identification documents of the members. In case the parties have not concluded any written contract, the registration of the simple partnership can be carried out by filing only the completed application form with all the required data, copy of the identification documents and by signing the relevant declaration for the acknowledgement, acceptance and application of the legal provisions in force in relation to the organization and functioning of the simple partnership. 3. Commercial Companies register with the Commercial Register by filing the application form for initial registration completed with all the required data in accordance with the present Law, the by-laws and incorporation act, in case they have been drafted in two different documents, the acts of appointing the bodies of the company, if they have not been included in the above acts, as well as other acts requested for incorporation in by the law in force. 4. Unlimited partnerships, limited partnerships and limited-liability companies may register also by filing only the application form for initial registration completed with all the mandatory data in accordance with the present law, the identification documents of
--	---

funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Ne këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortaket, anëtarët ose nga personat e autorizuar të veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

5. Degët dhe Zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji si dhe:

- a) aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçante, apo në mungesë aktin ekuivalent të krijimit sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme;
- b) dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj;
- c) dokumentacionin që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e saj të regjistrimit dhe përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;
- d) bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka patur aktivitet për më shumë se një vit;
- e) vendimin ose aktet e tjera të organit kompetent të shoqërisë së huaj sipas ligjit të juridiksionit të huaj për hapjen e degës ose zyrës së përfaqësimit. Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi që kërkon regjistrimin është njëkohësisht organi kompetent për të

the members or partners, and by signing the relevant declaration for the acknowledgement, acceptance and application of the legal provisions in force concerning the organization and functioning of the type of company being registered. In such case, the application for initial registration and the above mentioned declaration, signed by the partners, members or by the authorized persons to act on their name and behalf, substitutes the incorporation act and the by-laws of the company.

5. Branches and representation offices of foreign companies register by filing the application for initial registration completed with all the required data in accordance with the present law, as well as:

- a) incorporation act and by-laws of the parent company, in case these are drafted in two different documents, or the equivalent act of incorporation in accordance with the foreign law as well as all subsequent amendments;
- b) document certifying the registration of the foreign company in the foreign jurisdiction;
- c) document certifying the current state of the foreign company, issued within 90 days, with its registration and representation data, including the evidence of any liquidation and/or bankruptcy procedures;
- d) audited balance sheet and audit report of the foreign company for the last financial year, compiled in accordance with the standards required in the foreign country, if the foreign company has performed business for at least one year;
- e) decision or other acts of the competent body of the parent

vepruar i vetëm në emër të shoqërisë së huaj.

6. Shoqëritë dhe Unionet e kursim kredisë si dhe shoqëritë e bashkëpunimit reciprok, regjistrohen duke depozituar në Regjistrin Tregtar aplikimin për regjistrim fillestar të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 29
Subjektet e Huaja

1. Në rastet e regjistrimit të personave juridik ose shoqërive të thjeshta me ortak, aksionar ose anëtar një person juridik të huaj, përveç dokumenteve të kërkuara sipas llojit të subjektit, aplikimit për regjistrim fillestar i bashkëngjiten gjithashtu dokumentet e përcaktuar në pikat “a”, “b”, “c” dhe “e” të pikës 5 të nenit 28 më sipër në lidhje me personin juridik të huaj.

Neni 30
Te dhënat e detyrueshme për personat fizik

1. Për regjistrimin fillestar të personave fizik janë të detyrueshme të njoftohen

company according to the foreign jurisdiction for the opening of the branch or representation office. The acts mentioned in this point are substituted by the application for registration in case the person requiring registration is at the same time the competent body to act alone in the name of the foreign company.

6. Saving and Credit Companies and Unions, as well as Companies for Mutual Cooperation register by filing in the Commercial Register the application for the initial registration, completed with all the required data as provided by the present law, the by-laws and the incorporation act, in case they have been drafted in two separate documents, as well as any other document required in accordance with the law in force.

Article 29
Foreign subjects

1. In cases of registration of a legal entity or simple partnerships with partner, shareholder or member a foreign legal entity, apart from the documents required for the specific subject, the application for initial registration shall be accompanied by the documents defined in paragraph “a”, “b”, “c” and “e” of point 3, Article 28 above concerning the foreign legal person.

Article 30
Compulsory data for physical persons

këto te dhëna:

- a. Te dhënat e identifikimit;
- b. Vendin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik tregtar;
- c. Fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- d. Specimeni i nënshkrimit (firmës) të personit fizik;

Neni 31

Te dhënat e detyrueshme për shoqëritë e thjeshta

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta janë të detyrueshme të njoftohen këto te dhëna:
 - a. Kohëzgjatja, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
 - b. Fusha e veprimtarisë, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
 - c. Vendi i ushtrimit të aktivitetit ekonomik tregtar;
 - d. Të dhënat e identifikimit të anëtarëve;
 - e. Vlera dhe lloji i kontributeve të anëtarëve;
 - f. Te dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretet, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;
 - g. Specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

Neni 32

Te dhënat e detyrueshme për shoqëritë tregtare

1. The following data must be provided for the initial registration of physical persons:

- a. Identification data;
- b. The place of exercising the commercial economic activity;
- c. The object of activity, if it is determined;
- d. Specimen of signature of the physical person.

Article 31

Compulsory data for simple partnerships

1. The following data must be provided for the initial registration of ordinary partnerships:

- a. Duration, if it is determined;
- b. The object of activity, if it is determined;
- c. The place of exercising the commercial activity;
- d. Identification data of the members;
- e. Value and type of contributions by the members (if determined);
- f. Identification data of the persons responsible for the administration and representation of the company in relation to third parties, representation competences and the terms of their office;
- g. Specimen of signature of the persons representing the company in front of third parties.

Article 32

Compulsory data for commercial companies

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme të njoftohen këto të dhëna:
 - a. Emri;
 - b. Forma;
 - c. Data e themelimit;
 - d. Të dhënat e identifikimit të themeluesve;
 - e. Selia;
 - f. Objekti, në qofte së ky është i përcaktuar;
 - g. Kohëzgjatja, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
 - h. Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretet, kompetencat e përfaqësimit si dhe afatet e emërimit të tyre.
 - i. Specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

Neni 33

Te dhënat shtese për shoqëritë kolektive

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërisë kolektive, përveç sa parashikohet nga nenin 32 me sipër, është gjithashtu i detyrueshëm njoftimi i llojit e vlerës së kontributeve të të gjithë ortakëve, si dhe pjesëmarrja e tyre në kapital.

Neni 34

Te dhënat shtese për shoqëritë komandite

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërisë komandite, përveç sa

1. The following data shall be provided for the initial registration of commercial companies:
 - a. Name;
 - b. Form;
 - c. Date of incorporation;
 - d. Identification data of the founders;
 - e. Seat;
 - f. Object, if determined;
 - g. Duration, if determined;
 - h. Identification data of the responsible persons for the administration and representation of the company in relation to third parties, the representation competences and the terms of their office;
 - i. Specimen of signature of the persons representing the company in front of third parties.

Article 33

Additional data for unlimited partnerships

1. For the initial registration of unlimited partnerships, in addition to the provisions of Article 32 above, it is also compulsory to provide the kind and value of the contributions of the partners and their participation in the capital.

Article 34

Additional data for limited partnerships

1. For the initial registration of limited partnerships, in addition to

parashikohet nga nenin 32 me sipër është gjithashtu i detyrueshëm njoftimi i shumës ose vlerës së kontributeve të të gjithë ortakëve, pjesa në këtë shumë ose në këtë vlerë e çdo ortaku "të pakufizuar" ose të "kufizuar" si dhe pjesa e përgjithshme e ortakëve "të pakufizuar" dhe pjesa e çdo ortaku "të kufizuar" në shpërndarjen e fitimeve dhe në shumën që mbetet pas likuidimit të shoqërisë.

Neni 35

Te dhënat shtese për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përveç sa parashikohet nga neni 32 me sipër është gjithashtu i detyrueshëm njoftimi i vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar, numri i pjesëve të kapitalit, vlera nominale e secilës pjesë, pjesëmarrja në kapital, vlera dhe lloji i kontributeve të secilit ortak si dhe informacioni nëse kapitali fillestar i nënshkruar është i paguar ose jo.

Neni 36

Te dhënat shtese për shoqëritë anonime

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërisë anonime, përveç sa parashikohet nga neni 32 me sipër, është gjithashtu i detyrueshëm njoftimi i këtyre te dhënave;
 - a) vlera e kapitalit themeltar të nënshkruar, dhe pjesa e paguar;
 - b) numri dhe forma e aksioneve të nënshkruara;
 - c) vlera nominale e secilit aksion;
 - d) numri i aksioneve të nënshkruara nga secili aksionar;

the provisions of Article 32 above, it is also compulsory to provide the amount or value of the contributions of all the partners, the participation in such kind or value of each "unlimited" or "limited" partner as well as the general participation of all "unlimited" partners and of each "limited" partner in the distribution of profit and in the remaining value of the company after liquidation.

Article 35

Additional data for limited liability companies

1. For the initial registration of a limited liability company, in addition to the provisions of Article 32 above, it is also compulsory to provide the value of the initial share capital subscribed, number of shares, nominal value of each share, participation in the share capital as well as the kind and value of the contributions of each shareholder and also whether the initial subscribed share capital is paid, shall be also provided.

Article 36

Additional data for joint-stock companies

1. For the initial registration of joint-stock companies, in addition to the provisions of Article 32 above, it is also compulsory to provide:
 - a) the value of the initial capital subscribed, and the portion paid thereof;
 - b) the number and type of the subscribed shares;

e) vlera dhe lloji i kontributit të secilit aksionar si dhe pjesa e paguar prej secilit; f) kushtet e veçanta që kufizojnë transferimin e aksioneve (nëse ka); g) nëse ka kategori të ndryshme aksionesh, njoftohen të dhënat e shkronjave c) dhe f) me sipër për secilën kategori aksionesh, si dhe të drejtat që lidhen me to; h) procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut; i) vlera totale ose një parashikim i kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë në lidhje me procedurat e themelimit; j) avantazhe të veçanta që i njihen personave që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta që lidhen me fillimin e aktivitetit ekonomik (nëse ka); k) të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre; l) numri i anëtarëve të organeve drejtuese m) procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse të ndryshme nga parashikimet ligjore; 2. Shoqëritë anonime me oferte publike përpara regjistrimit fillestar duhet të regjistrojnë gjithashtu të dhënat e identifikimit të themeluesve, projekt statutin si dhe të kryejnë njoftimet e mëposhme sipas dispozitave përkatëse ligjore. 3. Të dhënat e përcaktuara në gerat e), f), g), h), i), j), m), të pikës 1 me sipër mund të njoftohen nëpërmjet referencës në aplikim të nenit	c) the nominal value of each share; d) number of subscribed shares by each shareholder; e) value and type of contribution of each shareholder, and portion paid by them; f) special conditions if any limiting the transfer of shares; g) where there are several classes of shares, the information under (c), and (f) for each class and the rights attaching to the shares of each class; h) procedures relating to the conversion of type of share, if provided in the by-laws; i) the total amount, or at least an estimate, of all the costs payable or chargeable to the company in relation to its formation; j) special advantage, if any, granted to persons involved in the formation of the company, or in transactions leading to the grant of the authorization to commence business. k) identification data of the Supervisory Board members and certified accountants, as well as the term of their office. l) number of members in governing bodies of the company; m) procedures for appointing members of the governing bodies of the company if different from the legal provisions. 2. Joint-stock companies with public offer must also file before the initial registration the identification data of the incorporators and the date of the deposit of the proposed by-laws and following notifications in accordance with the relevant law provisions. 3. Data provided in letters e), f), g), h), i), j), m), of the above point 1
---	---

përkatës të statutit ose aktit të themelimit, apo të dokumenteve shoqërues të depozituara.

Neni 37

Të Dhënat për Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit të Shoqërive të Huaja

1. Për regjistrimin fillestar të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja janë të detyrueshme të njoftohen këto të dhëna:
 - a. Të dhënat e përmbajtura në pikat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g” dhe “h” të nenit 32 në lidhje me shoqërinë e huaj, përfshi numrin dhe vendin e regjistrimit;
 - b. Kapitali i shoqërisë së huaj;
 - c. Emrin e degës ose zyrës së përfaqësimit, nëse i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj,
 - d. Kohëzgjatjen e degës ose zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
 - e. Fushën e veprimtarisë së degës ose zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
 - f. Selinë e degës ose zyrës së përfaqësimit;
 - g. Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretet, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit
 - h. Specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretet.

may be notified through a reference to the article of the articles of incorporation and by-laws, or with references to the other accompanying documents filed.

Article 37

Compulsory data for branches and Representative offices of foreign companies

1. The following data are required for the registration of branches and representation offices of foreign companies:
 - a. Data contained in a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g” dhe “h” of article 32 concerning the foreign company including registration data of mother company in the foreign country;
 - b. Capital of foreign company;
 - c. Name of the branch or representative office, if different from the parent company,
 - d. Duration of the branch or representative office, if it is determined;
 - e. Object of activity of the branch or representative office, if it is determined;
 - f. Registered office of the branch or representative office;
 - g. Identification data of the persons responsible for the administration and representation of the branch or representation office in relation to third parties, representation competences and their terms of office.
 - h. Specimen of signature (signs) of the persons representing the branch or representative office before third parties.

Neni 38

Te dhënat për Shoqëritë dhe Unionet Kursim Kredi

1. Për regjistrimin e shoqërive dhe unioneve kursim kredi, përveç sa parashikohet në nenin 32 me sipër në lidhje me shoqëritë tregtare, janë të detyrueshme të njoftohen edhe lloji dhe vlera e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, fakti nëse kapitali i nënshkruar është i paguar, si dhe pjesa e paguar, të dhënat e identifikimit të anëtarëve të komitetit mbikëqyrës, ekspertit kontabël të autorizuar si dhe afatin e emërimit të tyre.

Neni 39

Te dhënat për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok

1. Për regjistrimin e shoqërive të bashkëpunimit reciprok, përveç sa parashikohet në nenin 32 me sipër në lidhje me shoqëritë tregtare, njoftohet edhe lloji dhe vlera e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, fakti nëse kapitali i nënshkruar është i paguar, si dhe pjesa e paguar, përcaktimi i territorit të aktivitetit dhe të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, ekspertit kontabël të autorizuar si dhe afatin e emërimit të tyre.

Neni 40

Përjashtim

Article 38

Compulsory data for Savings and Credit Companies and Unions

1. For the registration of savings and credit companies and unions, in addition to the provisions of Article 32 above concerning commercial companies, it is also compulsory to provide the kind and value of each member in the capital of the company, whether the subscribed capital is paid, and the paid part, the identification data of the Supervisory Board's members, of the certified public accountant, as well as their term of office.

Article 39

Required data for mutual aid and cooperation companies

1. For the registration of Mutual Cooperation Companies, in addition to the provisions of Article 32, it is also compulsory to provide the kind and value of each member in the capital of the company, whether the subscribed capital is paid and the paid part, the determination of the territory of the activity and the identification data of the Supervisory Board members, of the certified public accountant, as well as their term of office.

Article 40

Exemption

1. In case special laws stipulate other forms of organization of the

1. Ne rastin kur me ligjet e posaçme parashikohen mënyra te ndryshme te organizimit te subjekteve atëherë te dhënat qe njoftohen duhet te jene ne përputhje me këto dispozita.

Neni 41
Pagesa e Kapitalit

1. Vërtetimi i shlyerjes së kapitalit themeltar nuk përbën kusht për regjistrimin fillestar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ne Regjistrin Tregtar, me përjashtim te rastit kur ligje te posaçme parashikojnë vërtetimin e pagesës se kapitalit si kusht për regjistrim.

Neni 42
Pasojat e regjistrimit fillestar

1. Subjektet qe regjistrohen si persona juridik e fitojnë personalitetin juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme.
2. Regjistrimi në Regjistrin Tregtar për Personat Fizik, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit të shoqërive te huaja, Shoqëritë e Thjeshta sipas Kodit Civil dhe subjektet e tjera që, sipas legjislacionit në fuqi nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet këtij regjistrimi, ka vetëm efekt deklarativ.

Seksioni IV
REGJISTRIMET E TJERA

registering subjects, the data provided must be in conformity with such provisions.

Article 41
Capital payment

1. The certification of payment of the share capital does not constitute a condition for the initial registration of limited liability companies with the Commercial Register, unless special laws provide for the certificate of payment of the capital as a condition for registration.

Article 42
Consequences of initial registration

1. Subjects registered as juridical entities gain their juridical personality with the registration with the Commercial Register, unless otherwise provided by special laws.
2. The registration with the Commercial Register for the Physical Persons, Branches and Representation Offices of the foreign companies, Simple Partnerships according to the Civil Code, as well as other subjects that according to the law in force do not gain juridical personality by means of such registration, has only declarative effects.

Section IV
OTHER REGISTRATIONS

Neni 43**Regjistrimet e tjera te detyrueshme**

1. Çdo subjekt që kryen regjistrimin fillestar mbart gjithashtu detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe dokumentet shoqëruese që depozitohen në regjistër sipas seksionit III më sipër.
2. Në rast ndryshimi të aktit të themelimit, statutit ose ndryshimit të kontratës së shoqërisë së thjeshtë (kur është në formë të shkruar), depozitohet gjithashtu edhe teksti i plotë i tyre që pasqyron ndryshimet e mëposhme. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja depozitohet statuti dhe akti i themelimit i shoqërisë së huaj apo dokumenti ekuivalent i krijimit sipas legjislacionit të huaj, me tekstin e plotë që pasqyron ndryshimet e bëra.
3. Përveç sa parashikohet në piken 1 më sipër të këtij neni subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:
 - a. bilanci vjetor kontabël dhe raporti i auditimit i mbajtur sipas dispozitave të legjislacionit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme; për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja depozitohet edhe bilanci vjetor i shoqërisë së huaj, i mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj;
 - b. emërimi dhe shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur emërimi është i detyrueshëm, numri i licencës profesionale si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;
 - c. emërimi i likuiduesve si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;

Article 43**Compulsory registrations**

1. Each subject performing the initial registration is obliged to register every modification in the announced data and the accompanying documents to be filed in the register according to Section III above.
2. In case of modification of the act of incorporation, bylaws or the simple partnership contract (provided it has written form) the full text document representing the modifications accomplished shall also be filed. For branches and representative offices of foreign companies, the documents submitted shall include statutes, acts of establishment or equivalent documents according to the foreign law, and submitted with their full text including any changes made.
3. Except as stipulated in paragraph 1 of the present Article, the subject must register and file the relevant documents, as follows:
 - a. The annual balance sheet and the audit report compiled in conformity with the provisions of the accounting legislation, when their compilation is mandatory; For the branches and the representation offices of foreign companies, the audited balance sheet and the audit report of the foreign company compiled in conformity with the standards requested in the foreign country;
 - b. Nomination and dismissal of the certified public account in case of obligatory nomination, the professional license

- d. pushimin e aktivitetit ekonomik tregtar, aktet e prishjes, mbylljes apo shpërndarjes, aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes së procedurave të likuidimit si dhe aktet e tjera ndërmjetme të parashikuara nga legjislacionit në fuqi. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen gjithashtu aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes dhe mbylljes së procedurave të likuidimit ose falimentimit të shoqërisë së huaj;
- e. vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit të ndryshme nga selia;
- f. dokumentet që vërtetojnë vënien e pengjeve ose garancitë e tjera mbi pjesëmarrjet në kapitalin e subjektit;
- g. çdo regjistrim tjetër i detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Pavarësisht nga sa më sipër, shoqëritë anonime nuk detyrohen të njoftojnë çdo transferim të aksioneve. Këto shoqëri, së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, njoftojnë listën e plotë të aksionareve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominativë, si dhe numrin e përgjithshëm të gjitha aksioneve.

Neni 44
Regjistrimet e tjera vullnetare

1. Subjektet mund të regjistrojnë çdo të dhënë tjetër të ndryshme nga të

number as well as their identification;

- c. Nomination of the liquidators as well as information for their identification;
- d. The termination of the economic commercial activity, the termination's acts, closure or dissolution, the acts for the opening of the liquidation procedures as well as any other intermediary acts as provided by the law in force. The acts of opening and closure of liquidation or bankruptcy of the mother company, for the branches and representative offices of foreign companies;
- e. Alternative locations of the exercise of the activity apart from the registered office;
- f. Any other obligatory registration in conformity with the provisions of the law in force.
- g. Securities or other guarantees on the participation in the capital of the subject;

4. Notwithstanding the above provision, joint stock companies are not obliged to notify each transfer of shares. These companies, together with the annual balance sheet and the audit report, also provide an updated list of registered shareholders with regard to nominative shares, and the total number of shares.

Article 44
Other voluntary registrations

1. Subjects may register any other data not contained in the above Article 43, related to the economic commercial activity of the

dhënat e përcaktuara në nenin 43 me sipër, të cilat kanë lidhje me aktivitetin e tyre ekonomik tregtar. Këto të dhëna shtese përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a. emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të aktivitetit (nëse i/të ndryshëm nga emri i regjistruar i subjektit);
- b. çdo transferim të aksioneve nominativë për shoqëritë anonime, që përveç personave të autorizuar mund të regjistrohet edhe me aplikimin e çdo aksionari të interesuar.
- c. web-site, e-mail, telefon dhe faks;
- d. vendime të organeve drejtuese të subjektit të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;
- e. të dhëna të tjera të lidhura me aktivitetin ekonomik tregtar të subjektit;

Neni 45

Regjistrimet me vendim të autoritetit publik

1. QKR regjistron në Regjistrin Tregtar dhe publikon, kryesisht ose me aplikim nga çdo person i interesuar, vendimet gjyqësore ose të autoriteteve të tjera publike që lidhen me të dhënat e regjistruara ose aktivitetin e Subjektit Tregtar. Aplikimit i bashkëngjitet vendimi përkatës.
2. Regjistrimi kryhet brenda afatit një ditor nga dita kur QKR-s i njoftohet vendimi përkatës, ose nga data e paraqitjes së kërkesës së palës.

subject. These additional data may include, without being limited to:

- a. The commercial name(s) or other distinctive mark (if different from the registered name of the subject);
- b. Any transfer of the nominative shares for joint stock companies, which can be registered as well by any of the interested shareholders;
- c. web-site, e-mail, telephone and fax;
- d. resolutions of the corporate bodies of the subject different from the decisions required for registration;
- e. other data connected to the economic commercial activity of the subject;

Article 45

Registrations with decision of the public authority

1. The NRC registers with the Commercial Register and publishes, ex officio or by means of application from any interested party, the decisions of the Court or other public authorities related to the recorded data and/or the activity of the Commercial Subject. The relevant decision is filed together with the application.
2. The registration is performed within a day starting from the date of the notification of the relevant decision to the NRC or from the date of the presentation of the request from the interested party.

Neni 46
Kalimi ne statusin pasiv

1. Çdo subjekt i cili nuk paraqit për 2 vite me radhe bilancin kontabël vjetor sipas parashikimit të nenit 43 të këtij ligji, njoftohet me shkrim nga QKR brenda 30 ditëve nga plotësimi i këtij afati.
2. Në rast se subjekti nuk plotëson detyrimin brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit por jo më vonë se 60 ditë nga plotësimi i afatit për paraqitjen e bilancit, subjekti kalohet kryesisht nga QKR në statusin pasiv me shënimin "PASIV" në të gjitha dokumentet që lëshohen nga regjistri.
3. Dispozitat e paragrafit 1 më sipër nuk zbatohen për subjektet që kanë njoftuar pezullimin e aktivitetit sipas neni 43.

Neni 47
Heqja e Statusit Pasiv

1. Subjekti hiqet nga statusi pasiv me kërkesë të personit të autorizuar, pasi plotëson detyrimin e paraqitjes së bilanceve dhe paguan sanksionet përkatëse.

Seksioni V
ÇREGJISTRIMI

Article 46
Passing to Inactive Status

1. Any subject of registration which for two consecutive years fails to submit the annual financial reports referred to in the Article 43 of this Law shall be notified in writing by the NRC, within the term of 30 days from the expiration of the submission term.
2. If the subject does not fulfill the obligation within 30 days of receiving the notification but not more than 60 days from the submission deadline, the subject is transferred by the NRC into the inactive status and marked: "INACTIVE".
3. The provisions of paragraph 1 above do not apply for the subjects that have notified the suspension of the activity as provided by Article 43.

Article 47
Removal of Inactive Status

1. The subject shall be removed from inactive status upon request of the authorized person, if such subject submits the balance sheets and pays the relevant administrative sanction.

Section V
CANCELLATION

Neni 48
Çregjistrimi i Subjektit Tregtar

1. Subjektet çregjistrohen nga Regjistri Tregtar ne rastet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi mbi prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridik, shpërndarjen e shoqërisë se thjeshte, ne rastet e përfundimit te ushtrimit te aktivitetit ekonomik tregtar te personit fizik, si dhe ne çdo rast tjetër te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.
2. Çregjistrimi behet:
 - a. ne mënyrë vullnetare nga subjekti;
 - b. ne baze te një vendimi gjyqësor te paankimueshem, ose
 - c. sipas parashikimit te ligjeve te posaçme.

Neni 49
Çregjistrimi vullnetar

1. Për personat fizik çregjistrimi ne mënyrë vullnetare kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim, i cili mund te behet se bashku me njoftimin e pushimit te aktivitetit ekonomik ose ne një moment të dytë.
2. Çregjistrimi ne mënyrë vullnetare për personat juridik, degët dhe zyrat përfaqësimit te shoqërive te huaja dhe për shoqëritë e thjeshta, kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim dhe depozitimit te akteve përkatëse qe vërtetojnë kryerjen dhe mbylljen e procedurave te likuidimit sipas legjislacionit ne fuqi. Çregjistrimi nuk kryhet nëse

Article 48
Cancellation of the Commercial Subject

1. The subjects are cancelled from the Commercial Register in the cases provided by the law in force regarding the termination and nullity of the juridical entities, the dissolution of the simple partnership, in the cases of the termination of the exercising of the business economic activities of the physical entity, as well as in any other case as provided by law.
2. Cancellation is performed:
 - a) voluntarily on the request of the subject
 - b) based on a definitive court decision
 - c) or in the cases provided by special laws

Article 49
Voluntary cancellation

1. With regard to a physical person, voluntary cancellation is performed through application for cancellation, which may be done together with the notice for the termination of the economic activity or in a subsequent moment.
2. The voluntary cancellation for juridical entities, and for branches and representation offices of foreign companies, is performed through application for cancellation and the filing of the appropriate documents verifying the performance and the closure of the liquidation procedures in conformity with the law

aktet e ndërmjetme te procesit te likuidimit sipas legjislacionit ne fuqi nuk janë njoftuar dhe depozituar pranë Regjistrit Tregtar. Këto akte depozitohen ne formën e kërkuar nga ky ligj dhe/ose nga dispozita te tjera ligjore ne fuqi.

Neni 50
Çregjistrimi ne rast vdekje

1. Ne rast vdekje te personit fizik, çregjistrimi mund te kryhet me kërkesë te çdo pale te interesuar, dhe me depozitim e dokumenteve përkatës. Gjithashtu, çdo pale e interesuar mund te kërkojë çregjistrimin e personit fizik nga Regjistri Tregtar duke depozituar vendimin e gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur.

Neni 51
Çregjistrimi me vendim te autoriteteve te tjera

1. Çregjistrimi nga Regjistri Tregtar kryhet mbi bazën e një vendim gjyqësor te paankimueshem, apo te vendimit perfundimtar te një autoriteti tjetër publik kur parashikohet nga ligje te posaçme, ne rastet e pavlefshmërisë se personave juridik pas mbylljes se likuidimit ne rruge gjyqësore, te falimentimit apo ne rastet tjera te parashikuara nga ligji.
2. QKR çregjistron kryesisht subjektin brenda 1 dite nga data e

in force. The cancellation is not performed in case the intermediate acts or documents of the liquidation process according to the law in force are not provided and filed with the Commercial Register in conformity with the present Law. These acts are filed in the form requested by the present Law and other legal provisions in force.

Article 50
Cancellation in case of death

1. In case of death of a physical person, cancellation can be accomplished on request of any interested party and by filing the appropriate documents. Furthermore, any interested party may request cancellation of the physical person from the Commercial Register by filing a Court decision declaring the person's death.

Article 51
Cancellation by decision of other authorities

1. Cancellation from the Commercial Register is performed based in definitive decision of the Court or of any other public authority when stipulated by other special laws, or in case of nullity of the juridical entity, liquidation by Court procedure, bankruptcy, or in any other cases provided by law.
2. The NRC cancels the registration ex officio within 1 day after the relevant decision.

marrjes se vendimit përkatës.

Neni 52

Te dhënat e subjekteve te çregjistruar

1. Te dhënat e subjekteve te çregjistruara mbahen nga Regjistri Tregtar duke kryer shënimin “i çregjistruar”, si dhe numrin e datën e vendimit gjyqësor ose te autoritetit tjetër publik sipas ligjeve te posaçme, qe ka vendosur çregjistrimin nga Regjistri Tregtar, ose ne rastin e çregjistrimit vullnetar, te dhënat e aktit dhe aplikimit nëpërmjet te cilit është kryer çregjistrimi. Këto te dhëna ruhen nga QKR ne format Elektronik dhe janë gjithnjë te aksesueshme për publikun.
2. Emri i Subjektit Tregtar do te konsiderohet i zënë sipas dispozitave te këtij ligji, për një afat prej 6 muaj nga data e çregjistrimit.

Neni 53

Pasojat e çregjistrimit

1. Çregjistrimi i personave juridik nga Regjistri Tregtar ka si pasoje humbjen e personalitetit juridik te subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje te posaçme.
2. Çregjistrimi nga Regjistrin Tregtar i Personave Fizik, Degëve dhe Zyra te Përfaqësimit te shoqërive te huaja, Shoqërive te Thjeshta sipas Kodit Civil, si dhe për Subjektet e tjerë qe sipas legjislacionit ne fuqi nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm

Article 52

Data of the Cancelled Subjects

1. The data of the cancelled Subjects are kept in the Commercial Register by adding the note “cancelled”, as well as the number and the date of the decision of the Court or of any other public authority in conformity with special laws, that has decided the cancellation from the Commercial Register, or in case of voluntary cancellation, the data of the act and of the application by means of which the cancellation is performed. Such information is retained permanently by the NRC in electronic format and is always accessible to the public.
2. The name of the subject shall be considered unavailable according to the provisions of the present law, for a duration of 6 months from the cancellation date.

Article 53

Consequences of Cancellation

1. Cancellation of the juridical entity from the Commercial Register causes the loss of the juridical personality of Subjects, unless otherwise provided by special laws.
2. Cancellation from the Commercial Register of the Physical Persons, Branches and Representation Offices of the foreign companies, Simple Partnerships according to the Civil Code, as

efekt deklarativ.

3. Subjektet të regjistruara, përgjigjen për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV VENDIMARRJA DHE PUBLIKIMI

Seksioni I SHQYRTIMI DHE VENDIMARRJA

Neni 54 Shqyrtimi i aplikimit

1. QKR asiston aplikantin në plotësimin e aplikimit dhe verifikon:
 - a. Identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;
 - b. Plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara si dhe dokumentet shoqëruese;
 - c. Paraqitjen në formën e kërkuar të dokumentacionit shoqërues që vërteton të dhënat që regjistrohen;
 - d. Faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë në mënyrë të dukshme të dhënat që përmbajnë dokumentet që shoqërojnë formularin;
 - e. Faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime a fshirje të pavërtetuara sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qarte, është e

well as for other Subjects that according to the law in force do not gain juridical personality by means of such registration, possesses only declarative effects.

3. The cancelled subjects are responsible for outstanding obligations toward third parties and public authorities in conformity with the law in force.

CHAPTER IV DELIBERATION AND PUBLICATION

Section I REVIEW AND DELIBERATION

Article 54 Review of the Application

1. NRC assists the applicant with the filing of the application and verifies:
 - a. The identity of the signer of the documents and the fact whether he or she is authorized to perform the registration;
 - b. The filling of all compulsory information as well as the accompanying documentation;
 - c. The presentation of the complete documentation in the requested form verifying the declared data;
 - d. The fact whether the data expressed in the registration form evidently does not contradict the data contained in the accompanying documentation attached to the form;

palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik; f. Nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet; g. Pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim; h. Faktin nëse aplikanti ka shlyer sanksionet administrative të aplikuara sipas nenit 74 të këtij ligji. 2. QKR nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve që i bashkëngjiten aplikimit për regjistrim. 3. QKR lëshon një konfirmim me shkrim sipas një formati të miratuar për çdo aplikim të dorëzuar. 4. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë kohën e dorëzimit, numrin rendor të paraqitjes së aplikimit, objektin e aplikimit, listën e dokumenteve të dorëzuara dhe shumën e tarifës së paguar. 5. QKR merr në shqyrtim aplikimet për regjistrim sipas radhës së paraqitjes së tyre. 6. QKR është e detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim të paraqitur sipas këtij ligji, e dokumentet e bashkëngjitur, edhe nëse aplikimi është i paplote, apo dokumentet shoqëruese e pasakte. Në çdo rast, QKR përgjigjet me shkrim.	e. The fact whether the presented documentation contains corrections or uncertified deletions according to the relevant legal provisions, and their content must be clear, legible and to allow the assumption of the electronic image of the document; f. Whether the chosen name can be registered; g. The payment of the relevant registration fee; h. The fact that the applicant has unpaid fines applied according to article 74 of this law; 2. NRC cannot examine the accuracy of the data or the veracity of the documents attached to the application for registration. 3. NRC issues a written confirmation for each filed application based on a standard approved form. 4. The written confirmation is issued according to the approved format and must specify the filing date, number of registration of the application, object of registration, list of submitted documents and the amount of fee paid. 5. NRC processes the registering applications based on the order of filings. 6. NRC is obliged to accept the submission of every presented application and other accompanying documents, even if the application is incomplete or the accompanying documents are inaccurate. In any case NRC replies in writing.
--	--

Neni 55
Pranimi i regjistrimit

1. QKR, pasi kryen verifikimet përkatëse sipas nenit 54 me sipër dhe konstaton përmbushjen e kushteve për regjistrim sipas këtij ligji, kryen regjistrimin ne Regjister dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një afati prej 1 dite nga data e paraqitjes se aplikimit.
2. QKR nuk mund te refuzoje regjistrimin nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve te këtij ligji.

Neni 56
Pezullimi i aplikimit

1. Ne rastet kur pas verifikimeve te parashikuara ne nenin 54 me sipër, rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim sipas këtij ligji, nuk janë paguar tarifat përkatëse te regjistrimit apo ka sanksione administrative te papaguara, QKR pezullon aplikimin, dhe i njofton aplikantit me shkrim shkakun e sakte te pezullimit, duke i dhënë një afat 15 ditor për plotësimin ose ndreqjen e elementeve qe pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut te pezullimit behet nëpërmjet një formulari standard te QKR.
2. Nëse aplikanti plotëson ose ndreq elementet qe pengojnë regjistrimin brenda afatit te mësipërm, QKR është e detyruar te kryejë regjistrimin brenda një afati 1 ditor nga data e plotësimit ose ndreqjes se dokumentacionit. Ne këtë rast regjistrimi mban datën e paraqitjes se aplikimit te pare.

Article 55
Approval of the registration

1. NRC, after performing the necessary verifications according to article 54 above and ascertain the fulfillment of conditions for registration according to this law, performs the registration in the Register and issues the registration certificate within the mandatory term of 1 day from the presentation of the application.
2. NRC cannot refuse the registration of a subject if the application for registration is submitted in conformity with the provisions of the present Law.

Article 56
Suspension of the Application

1. In case when after the verifications of article 54, results that the conditions for registration required by this law are not met, the tariffs and/or administrative fines are not paid, NRC suspends the application and gives written notice to the applicant of the reason of suspension, granting a 15-day term to complete or correct the elements that impede the registration. The reason of the suspension shall be notified through a standard form of the NRC.
2. In case the applicant completes or corrects the elements that impede the registration within the abovementioned term, NRC is

Neni 57
Refuzimi i regjistrimit

1. Regjistrimi refuzohet vetëm ne këto raste:
 - a. Aplikimi nuk është ne përputhje me kushtet e këtij ligji, dhe Aplikanti nuk plotëson ose ndreq elementet që pengojnë regjistrimin brenda afatit;
 - b. Te dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga te dhënat e regjistrueshme sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Refuzimi i njoftohet aplikantit me shkrim sipas formularit standard, dhe përmban shkakun e këtij refuzimi.
3. Riparaqitja e aplikimit pas refuzimit trajtohet si aplikim i ri.

Neni 58
Miratimi i Heshtur

1. Ne rastin kur QKR, brenda afatit prej 1 dite sipas neneve me sipër, nuk kryen regjistrimin, nuk njofton pezullimin e aplikimit apo nuk njofton refuzimin, atëherë aplikimi për regjistrim quhet i pranuar menjëherë.

obliged to perform the registration within the term of 1 day from the data of the completion or correction of the documentation. In this case the registration bears the date of filing of the first application.

Article 57
Denial of Registration

1. Registration is denied only in the following cases:
 - a. The application does not comply with the registration conditions provided in this law and the applicant does not complete or correct the elements that impede the registration within the determined term;
 - b. The data to be registered are different from the data that may be registered with the Register in conformity with the provisions of the present law.
2. The denial is notified in written form to the applicant according to the standard form and contains the reason of such refusal.
3. Re- submission of the application following the denial is considered as new application.

Article 58
Silent Consent Rule

1. In case that NRC, within the mandatory term of 1 day according to the above provisions, does not perform the registration, notify the suspension of the application or does not notify the denial, the registration shall be considered as

2. QKR detyrohet të kryejë publikimin e të dhënave të regjistruara.

Seksioni II

REGJISTRIMI I NJEKOHSEM, NUMRI UNIK I IDENTIFIKIMIT, PUBLIKIMI DHE LESHIMI I CERITIFIKATAVE

Neni 59

Regjistrimi i Njëkohshëm

1. Regjistrimi i subjekteve në Regjistrin Tregtar përben gjithashtu regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë autoriteteve tatimore, në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës.
2. Për qëllimet e regjistrimit të pajisjes me certifikatën e regjistrimit fillestar, subjektet deklarojnë gjithashtu të dhënat e detyrueshme sipas legjislacionit tatimor të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave sipas formularëve përkatës.

Neni 60

Numri unik i identifikimit të subjektit

1. Me regjistrimin në regjister, subjekteve u jepet numri i identifikimit, i cili gjenerohet në mënyrë elektronike nga QKR dhe

immediately accepted.

2. NRC is obliged to publish the registered data.

Section II

SIMULTANEOUS REGISTRATION, UNIQUE IDENTIFICATION NUMBER, PUBLICATION, AND ISSUANCE OF CERTIFICATES

Article 59

Simultaneous registration

1. The registration of the abovementioned subjects with the Register constitutes also the simultaneous registration with the tax authorities, social and health insurance scheme and by the employment inspectorate.
2. For the purposes of the initial registration, and issuance of the registration certificate, the subjects also declare the mandatory data in accordance with the tax, social and health insurance and statistical law provisions in force.

Article 60

Unique Identification Number of the subject

1. By means of registration with the Registers, subjects are given an identification number, which is electronically generated by

është unik për çdo Subjekt të regjistruar.

2. Numri Unik i Identifikimit të Subjektit është i vlefshëm për identifikimin e subjekteve për qëllimet e regjistrimit në regjistër, për qëllimet e regjistrimit si person i tatueshëm pranë autoriteteve fiskale qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues.
3. Numri Unik i Identifikimit të Subjektit jepet vetëm njëherë në momentin e regjistrimit fillestar dhe do të jetë i pandryshueshëm si dhe nuk do të jepet subjekteve të tjera edhe pas cregjistrimit.
4. Subjektet e regjistruara janë të detyruar të shënojnë Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit në çdo korrespondencë të tyre.

Neni 61 **Publikimi elektronik**

1. Çdo e dhënë e regjistruar në regjister nga QKR publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga QKR në format elektronik dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit.
2. QKR kryen publikimin në Buletin brenda një dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qarte data në të cilën e dhëna është regjistruar e publikuar.

NRC, and is unique for each of the registered subjects.

2. The Subject Unique Identification Number is valid for the identification of the Subject for the purpose of registration in the Register, as well as for the purpose of registration with the local and national tax authorities, for the scheme of social security and healthcare, the employment inspectorate as well as for any other statistical or identification matter.
3. Subject Unique Identification Number is given only once, at the moment of the initial registration, and shall not change until the and shall not be granted to other subjects after the cancellation.
4. The registered subjects shall evidence the Subject Unique Identification Number in every correspondence with third parties.

Article 61 **Electronic publications**

1. Each registered data kept by the NRC is published in the Bulletin of Official Registration Notices that NRC maintains in electronic format and is published in its official website.
2. The NRC performs the publication in the Bulletin within one day from the date of registration. Each publication must clearly state the date of data registration.

3. QKR për çdo dite pune publikon ne Buletinin te gjitha regjistrimet e kryera gjate ditës se mëparshme.
4. Publikimi ne Buletinet e Njoftimeve Zyrtare te Regjistrimit përbën publikim zyrtar te regjistrimeve te kryera ne kuptim te nenit 21 te këtij ligji.
5. Me vendim te Ministrit mund te parashikohen botime te tjera ndihmese për njoftimin e regjistrimeve. Ne çdo rast këto botime nuk cënojnë efektet e publikimit sipas pikave 1 deri 3 te këtij neni.

Neni 62
Certifikatat e Regjistrimit fillestar

1. Brenda afatit te përcaktuar ne këtë ligj për regjistrimin fillestar, QKR i lëshon subjektit te regjistruar certifikatën e regjistrimit e cila përmban emrin, formën, Numrin Unik te Identifikimit te Subjektit, datën e regjistrimit fillestar dhe selinë ose adresën e vendit kryesor te ushtrimit te aktivitetit.
2. Ne rast se subjekti i regjistruar ushtron aktivitet ne me shume se një vend, QKR lëshon nga një certifikate regjistrimi për çdo vend te ushtrimit te aktivitetit. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë gjithashtu emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe Numrin Unik te Identifikimit te Subjektit.
3. Ne rastet kur subjekti ndryshon emrin, formën, selinë apo vendet e

3. For every working day NRC publishes in the Bulletin all registration performed during the previous day.
4. Publication of registrations in the Bulletin of Official Registration Notices is the official publications for the purposes of Article 21 of this Law.
5. By decision of the Minister there may be provided other auxiliary forms for notification of registrations. In any case such notifications shall not prejudice the provisions of paragraphs 1 to 3 of the present article.

Article 62
Certificates for Initial Registration

1. Within the term set forth in the present law regarding the initial registration, NRC issues to the subject the Registration Certificate, which includes the name, form, the Subject Unique Identification Number, date of registration and registered address or the address of the core location of the exercise of the activity.
2. In case the registered subject exercises activities in more than one location, NRC issues registration certificates for each and any of such locations. Such certificates, besides the relevant address, include also the denomination, form, date of initial registration and the Subject Unique Identification Number.

ushtrimit te aktivitetit, QKR zëvendëson certifikatat e lëshuara me pare me një certifikatë te re për çdo vend te ushtrimit te aktivitetit. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë gjithashtu emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe Numrin Unik te Identifikimit te Subjektit.

4. Certifikata e regjistrimit lëshohet ne një origjinal për çdo vend te ushtrimit te aktivitetit. Ne rast humbje apo dëmtimi te certifikatës se regjistrimit ajo zëvendësohet me një dublikate te lëshuar nga QKR.
5. Subjekti detyrohet te afishoje Certifikatën përkatëse ne çdo vend te ushtrimit te aktivitetit.

Neni 63
Vërtetime për regjistrimet

1. Me kryerjen e çdo regjistrimi sipas dispozitave te këtij ligji, QKR i lëshon subjektit një vërtetim te regjistrimit ku përcaktohet qarte veprimi i kryer dhe data e këtij regjistrimi.

Neni 64
Formati dhe Përmbajtja

1. Ministri, me propozim te Titullarit te QKR miraton formatin dhe përmbajtjen e certifikatave, vërtetimeve dhe te Buletinit te Njoftimeve

3. In cases the subject changes its name, the registered address or the locations of exercise of the activity, NRC substitutes the previous issued certificates with new certificates for each and any location of exercise of the activity. Such certificates include the name, form, date of initial registration, registered address or the new addresses of exercise of the activity, and also the Subject Unique Identification Number.

4. The registration certificate is issued in one original for every place of activity. In case of loss or damage of the registration certificate it is substituted with a duplicate issued by the NRC.

5. The subject is obliged to affix the relevant certificate in for every place of activity.

Article 63
Other types of certificates

1. With the performing of any registration in conformity with the provisions set forth in the present law, NRC issues to the subject a certificate clearly determining the registration performed and the date.

Article 64
Format and Content

1. The Minister, upon proposal of the Director of the NRC, approves the format and content of the certificates and the

Zyrtare te Regjistrimit sipas këtij ligji.

Neni 65
Korrigjimi i Gabimeve

1. Pasaktësitë, gabimet e shtypit ose gabimet te tjera te dukshme të këtij lloji, të bëra gjatë regjistrimeve te cilat rezultojnë qarte nga dokumentacioni i depozituar dhe nuk cenojnë vlefshmërinë e regjistrimit mund te korrigjohen nga QKR kryesisht apo me kërkesë te personave te interesuar.
2. Ndryshimi i te dhënave te pasakta te ndryshme nga ato te parashikuara ne piken 1 kryhet nëpërmjet një aplikimi te ri, apo ne baze te një vendimi gjyqësor.
3. Ndreqja e pasaktësive apo gabimeve publikohet sipas dispozitave te nenit 61 te këtij ligji.
4. Aplikimi për ndreqje te gabimeve kryhet pa pagesë.

KREU V
AKSESI PUBLIK DHE EKSTRAKTET

Neni 66
Kërkimet ne Bazën e te Dhënave

Bulletin of Official Registration Notices in conformity with the present Law.

Article 65
Correctable Errors

1. Inaccuracies, typing errors and other visible errors of the same kind, committed upon registration which are clearly visible from the submitted documents and do not harm the validity of the registration, can be corrected by the NRC at its discretion or upon request by interested parties.
2. The amendment of incorrect data, different from that stipulated by paragraph 1, are performed through a new application or based on a court decision.
3. The correction of errors is disclosed according to Article 83 of the present Law.
4. The application for error correction is free of charge.

CHAPTER V
PUBLIC ACCESS AND ABSTRACTS

Article 66
Search in the Database

1. Çdo e dhënë e regjistruar ne regjister, si dhe imazhi i plote elektronik i çdo dokumenti shoqërues është lirisht i aksesueshëm për publikun ne faqen zyrtare te internetit te QKR, përveç adresës se banimit te individëve, qe ne përputhje me këtë ligj e kane njoftuar këtë te dhënë.

2. QKR mundëson kryerjen e kërkimeve ne bazën elektronike te të dhënave pranë çdo sporteli shërbimi.

Neni 67 **Ekstraktet e Regjistrit**

1. Çdo person ka te drejte te kërkoje lëshimin e ekstrakteve mbi një pjese apo te gjitha te dhënat e regjistruara dhe kopje te vërtetuara te dokumenteve shoqëruese te depozituara ne regjistër, pranë çdo sporteli shërbimi te QKR.

2. Ekstraktet mund te lëshohen mbi te dhëna te caktuara te subjekteve, dhe/ose mbi historikun e veprimeve te kryera nga një subjekt.

3. Te dhënat për adresën e banimit te individëve sipas pikës 1 te nenit 66, janë te aksesueshme nga çdo person i interesuar, vetëm ne baze te një kërkesë qe përmban identitetin e kërkuarit.

4. Ministri, me propozim te Titullarit te QKR miraton formatin e ekstrakteve dhe te kërkesës për lëshimin tyre.

1. Each registration of data in the Register as well as the complete electronic image of every accompanying document is freely accessible for the public in the NRC official website, except the domicile of individuals, notified according to this law.

2. NRC enables the performance of research in the electronic database, at each of the service windows.

Article 67 **Abstracts from the Register**

1. Every person has the right to request issuance of abstracts for part or all the recorded data and certified copies of the accompanying acts submitted in the Register, at any of the service windows of the NRC.

2. Extracts may be issued on determined data of the subjects, and/or on historical operations performed by a subject.

3. Data related to the domicile of individuals according to point 1 of article 66, are accessible through a request where is evidenced the identity of the person requesting such data.

4. The Minister, upon proposal of the Director of NRC, approves the format of abstracts and of the requests for their issuance.

Article 68

Neni 68
Vlera Ligjore e Ekstrakteve

1. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqërues, të lëshuara nga QKR kanë vlerën kopjeve të vërtetuara të të dhënave të regjistruara apo dokumenteve shoqërues përkatës.
2. Ekstraktet dhe kopjet e akteve të lëshuara në format elektronik, nëpërmjet aksesit *on-line* në bazën e të dhënave të Regjistrimit kanë vlerën ligjore të përcaktuar në legjislacionin për dokumentet elektronike.

Neni 69
Komunikimi elektronik me autoritete të tjera publike

1. Për të garantuar lehtësimin e procedurave të regjistrimit, dhe ofrimin e shërbimeve të tjera shtese në favor të subjekteve të interesuara, QKR, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bashkëpunon me autoritete të tjera publike dhe mundëson ndërlidhjen dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave të regjistruara në bazën e saj elektronike, me regjistra apo baza të dhënash elektronike të autoriteteve të tjera publike si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU VI
LICENCIMET

Neni 70

Legal Value of Abstracts

1. Abstracts and certified copies of the acts issued by NRC have the value of certified copies of registered data and relevant accompanying documents.
2. Abstracts and certified copies of the accompanying documents, issued in electronic format through on-line access on the database of the Register shall have the legal value set forth by the law on electronic evidence.

Article 69
Electronic communication with other public authorities

1. In order to guarantee the facilitation of the registration procedures and the offering of other additional services in favor of the interested subjects, the NRC, in conformity with the law in force, cooperates with other public authorities and enables on-line access and the electronic exchange of the information recorded in its database with other registers or databases of other public authorities, in the territory of the Republic of Albania and abroad.

CHAPTER VI
LICENSING

Article 70

Funksionet ne lidhje me licencimin 1. QKR informon dhe këshillon publikun mbi licencat, lejet dhe autorizimet administrative për kryerjen e aktivitetit, kushtet dhe procedurën për përfitimin e tyre. 2. QKR është sportel pritës për aplikim për licencat lejet dhe autorizimet administrative dhe tërheqjen e tyre nga aplikantët. 3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të caktojë me akte nënligjore, llojet e licencave, lejet dhe autorizimet administrative dhe procedurat përkatëse për të cilat QKR ofron shërbimin e këshillimit dhe të sportelit pritës për aplikim dhe tërheqje.	Functions Concerning Licensing 1. NRC informs and advises the public on licenses, permits and administrative authorizations for the performance of the activity, the conditions and procedures for their obtainment. 2. NRC functions as an application service window for licenses, permits and administrative authorizations and their withdrawal by the applicants. 3. The Council of Ministers is in charge of defining, by regulations, the types of licenses, permits and administrative authorizations and the relative procedures for which the NRC may offer advisory services and an application service window for application and withdrawal.
KREU VII ANKIMI DHE KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE Neni 71 Ankimi administrativ 1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj veprimeve apo mosveprimeve të QKR në lidhje me regjistrimet dhe publikimet sipas dispozitave të këtij ligji. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur ankuesi ka marrë njoftimin për pranimin apo refuzimin e regjistrimit sipas	CHAPTER VII COMPLAINTS AND SANCTIONS Article 71 Administrative Complaint 1. Any interested party has the right to administratively complain against the actions or omissions of the NRC concerning the registrations and publications in accordance with the provisions of this law. The complaint is made within 30 days after the day the complainant has received

këtij ligji, ose nga dita kur regjistrimi është publikuar ne Buletinin e Njoftimeve Zyrtare te Regjistrimit.

2. Në rastet kur ky ligj parashikon miratimin e heshtur dhe QKR nuk leshon certifikatat apo nuk kryer publikimet perkatese brenda afatit te parashikuar subjekti ka te drejte te ankohet ne cdo kohe ne rruge administrative duke kërkuar lëshimin e certifikatës se regjistrimit fillestar, apo certifikatës qe vërteton regjistrimet e tjera te kryera, si dhe publikimin e këtyre te dhënave sipas dispozitave te këtij ligji.
3. Çdo person i interesuar ka te drejte te ankohet ne rruge administrative kur QKR nuk lëshon ekstraktet apo kopjet e vërtetuara te akteve sipas dispozitave këtij ligji. Afati 30 ditor për paraqitjen e ankimit fillon pas 5 ditëve nga dita e depozitimit te kërkesës për lëshimin e ekstraktit apo kopjes se aktit te kërkuar.

Neni 72
Organi Kompetent për Ankimin

1. Ankimi administrativ sipas nenit 71 me sipër, i drejtohet Titullarit te QKR dhe paraqitet sipas formave e procedurave te përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative, ne selinë qendrore te QKR ose ne çdo sportel shërbimi te saj.

notification of the approval or refusal of the registration according to this law, or from the day the registration has been published in the Bulletin of Official Registration Notices of the NRC.

2. In the cases where this Law provides for the silent consent and NRC does not issue the relevant certificate and/or does not perform the relevant publications within the terms provided in this law, the subject may at anytime file an administrative claim requesting the issuance of the initial registration certificate, or of the certificate that certifies the other performed registrations, as well as the publication of these data in accordance with the provisions of this law.
3. Any interested person has the right to administratively complain when NRC does not issue the extracts or certified copies of the acts in accordance with the provisions of this Law. The 30-days term for the introduction of a complaint starts 5 days after the day of filing the request for the issuance of the extract or copy of the required act.

Article 72
Competent Authority

1. The administrative complaint under article 71 above is directed to the Director of NRC and is presented in accordance with the procedural forms defined in the Administrative Procedures Code, in the central office of the

2. Titullari i QKR shqyrton ankimin, merr vendim dhe ia njofton palës se interesuar brenda 5 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit.
3. Ndaj aktit të titullarit të QKR apo mosveprimit të tij mund të behet ankim drejtpërdrejt në gjykatë sipas nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 73
Përgjegjësia Jashtkontraktore

1. QKR, në përputhje me ligjin për demin jashtëkontraktor të administratës publike, përgjigjet për demet e shkaktuara nga mosveprimi ose nga veprimi në kundërshtim me ligjin.

Neni 74
Kundërvajtjet Administrative

1. Subjekti përgjigjet sipas ligjeve në fuqi mbi vërtetësinë e fakteve dhe të dhënave të njoftuara dhe dokumenteve shoqëruese të depozituara në Regjister.
2. Deklarimi i të dhënave të pavërteta në Regjister, në rast se nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobe 15 000 Lek.

NRC or in any of its service windows.

2. The Head of the NRC reviews the complaint, takes a decision and notifies the interested party within 5 days from the filing of the complaint.
3. A complaint against the actions or omissions of the Director of the NRC is possible directly to Court in accordance with Article 328 of the Civil Procedure Code.

Article 73
Non Contractual Liability

1. The NRC, in accordance with the law on the extra-contractual damage of the public administration, is responsible for the damage caused by the omission or action in violation of the law.

Article 74
Administrative Sanctions

1. The subject is responsible in accordance with the laws in force on the truthfulness and veracity of the facts and data notified and acts filed with the registers.
2. The declaration of false data with the registers, in the case it does not constitute a criminal act, constitutes an administrative contravention and is punishable by fine of 15 000 Lek.

3. Mos kryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme brenda afateve të parashikuara nga ky ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobe 15 000 Leke.
4. Mosveprimi i subjektit të cili sjell si pasoje kalimin në statusin Pasiv sipas nenit 46 me sipër, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobe 15 000 Leke.
5. Gjoka aplikohet nga Titullari i QKR, vendimi i të cilit ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë.

KREU VIII
DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 75
Procedurat e Regjistrimit të Subjekteve Ekzistuese

1. Regjistri i Shoqërive tregtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, regjistri i personave fizike tregtare pranë gjykatave përkatëse të rretheve, regjistri i shoqërive dhe unioneve të kursim kreditit, regjistri i shoqërive të bashkëpunimit reciprok, së bashku me dokumentacionin shoqëruar, transferohen në administrimin e QKR në format material dhe elektronik brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. The non-accomplishment of the duty for the initial registration and other compulsory registrations within the terms provided by this law constitutes an administrative contravention and is punishable by fine of 15 000 Lek.
4. An omission by a subject that causes its transfer to inactive status according to article 46 above constitutes an administrative contravention punishable by fine of 15 000 Lek.
5. The fine is applied by the Director of NRC, the decision of whom may be object of a complaint directly to Court.

CHAPTER VIII
TRANSITORY AND FINAL DISPOSITIONS

Article 75
Registration procedures of existing companies

1. The register of commercial companies within the Tirana District Court, the register of commercial natural persons within the respective District Courts, the register of savings and credit companies and unions and the register of cooperation companies, together with the accompanying documentation, shall be transferred under the administration of the NRC in paper form and electronic form within 3 months from the entry into force of the present law.
2. The tax authorities, within 3 months from the entry into force of

2. Organet tatimore brenda 3 muajsh nga hyrja ne fuqi e këtij ligji i japin QKR te gjitha te dhënat qe ato kane për subjektet e regjistruara ne regjistrat e parashikuar ne paragrafin 1 me sipër, për aq sa ato janë te domosdoshme për te shënuar Numrin Unik te Identifikimit te Subjektit. 3. Te gjitha te dhënat e regjistrave dhe dokumentet shoqërues qe transferohen pranë QKR regjistrohen dhe publikohen kryesisht nga QKR pa pagese sipas parashikimeve te këtij ligji. 4. Te gjithë subjektet dhe regjistrimet përkatëse ne këto regjistra konsiderohen automatikisht te reregjistruar ne regjistrin tregtar, qe nga data e regjistrimit te pare. 5. Ne qofte se nga procesi i reregjistrimit evidentohen subjekte me emra te njëjtë ose te ngjashëm, QKR publikon ne një seksion te veçante te faqes zyrtare te internetit një liste te plote te këtyre subjekteve, duke saktësuar datat e regjistrimit te secilit ne gjykate. 6. Subjektet qe janë regjistruar me pare ne regjistrat e parashikuara ne paragrafin 1 me sipër dhe nuk kane kryer regjistrim tek organet tatimore publikohen ne një seksion te veçante te faqes se internetit te QKR. Ne rast se këto subjekte nuk njoftojnë fillimin e aktivitetit tregtar brenda një afati prej 6 muajsh nga data e këtij publikimi, QKR kryen kryesisht cregjistrimin e tyre nga regjistri. 7. Subjektet qe megjithëse kane kryer regjistrimin pranë organeve	the present law, shall provide to the NRC all the data they possess on the subjects described in paragraph 1 above, to the extent that such data are indispensable for recording the Subject Unique Identification Number. 3. All the data contained in the registers and related documents being transferred in NRC shall be registered and published routinely by NRC without any fee according to the provisions of this law. 4. All the Subjects and respective registrations in these Registers are considered automatically re-registered in the Commercial Register from the date of the initial registration. 5. If, from the process of the re-registration, Subjects with the same or similar names are discovered, NRC publishes in a separate section of its webpage a full list of Subjects who have identical or similar names, specifying their date of registration with the Court. 6. Subjects registered initially in the registers provided in paragraph 1 above and which have not registered with the tax authorities are published in a special section of NRC webpage. In case these Subjects do not notify the starting of the activity within 6 months from the date of such publication, NRC carries out routinely the de-registration from the relevant Register. 7. Subjects that, although they have registered with the tax authorities, have erroneous or incomplete registrations, are published by NRC in a separate section of its webpage,
---	--

tatimore kane regjistrime te pasakta apo te pa plota publikohen ne një seksion te veçante te faqes se internetit te QKR, duke specifikuar te dhënat e pasakta apo te paplota, si dhe veprimin qe duhet te ndërmerret apo dokumentin shoqërues qe duhet te depozitohet. Ne rast se këto subjekte nuk njoftojnë, saktësojnë regjistrimet ose depozitojnë dokumentet shoqëruese përkatëse brenda një afati prej 6 muajsh nga data e këtij publikimi, kalohen kryesisht nga QKR ne statusin “pasiv”.

8. Gjykatat perkatese vazhdojne te pranojne kërkesa per kryejen e veprimeve te regjistrimit deri ne daten e fillimit te regjistrimeve nga QKR sipas afateve te parashikuara ne piken 2 te nenit 77 te këtij ligji. Aplikimet e regjistrimeve ne proces dhe te pa përfunduara ne kete datë, kryhen nga gjykatat perkatese ne përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji përveç rastit kur aplikanti tërheq aplikimin dhe vendos ta paraqesë atë pranë QKR. Te gjitha regjistrimet e kryera dhe dokumentacioni shoqërues i depozituar gjate kësaj periudhe i kalon menjëherë QKR nga gjykata përkatëse.
9. Ankimet ndaj regjistrimeve te kryera nga gjykatat deri ne afatin e parashikuar ne piken 8 me siper, shqyrtohen sipas procedures te parashikuar nga ligji i mëparshëm.
10. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri ngarkohen te përcaktojnë me urdhër te përbashkët procedurën e transferimit pranë QKR te regjistrave te përcaktuar ne piken 1 te këtij neni.

specifying which data is incorrect and the action to be taken or the accompanying document to be filed. In case these Subjects do not notify corrected data or submit the necessary accompanying documents within 6 months from the date of such publication, are determined to be given “passive” status.

8. The respective courts continue to accept the application for registration till NRC starts operating in accordance with deadline provided by article 77/2 of this law. Ongoing registration applications and those unfinished as to this date are carried by the courts out in accordance with the procedure applicable prior to the entry into force of this law, unless the applicant withdraws the applications and decides to present it to the NRC. All the registrations concluded, and the related documentation filed, during this period are transferred immediately to the NRC by the relevant court.
9. Complaints introduced against the registration made by the courts till the deadline as provided by point 8 above, follow the procedure provided by the previous law.
10. The Minister of Justice and the Minister are in charge of defining by common order the procedure for the transfer to the NRC of the Registers provided in paragraph 1 of this article.
11. For the cases provided in paragraph 7 above, the subject is removed from the inactive status with the notification of correct data together with the filing of the relevant accompanying

11. Ne rastet e parashikuara nga paragrafi 7, me sipër, subjekti hiqen nga statusi pasiv me njoftimin, saktësimin e regjistrimit ose me depozitimin e dokumenteve shoqëruese. Ne këto raste, nuk aplikohet sanksion administrativ.

12. Subjektet që reregjistrohen sipas këtij neni pajisen nga QKR me certifikata regjistrimi në përputhje me dispozitat e nenit 62 të këtij ligji në momentin kur aplikojnë për kryerjen e një veprimi në Regjister. Deri në këtë moment, certifikatat e regjistrimit pranë organeve tatimore janë të vlefshme.

Neni 76

Aktet Nënligjore në Zbatim të Ligjit

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë procedurat e detajuara të shqyrtimit, miratimit, pezullimit, refuzimit të aplikimit dhe publikimit për regjistrim fillestar, për regjistrimet e tjera dhe çregjistrimin e subjekteve, si dhe procedurën e hollësishme të ndreqjes së gabimeve në regjistrim në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë procedurat e detajuara për deklarimin, trajtimin dhe shkëmbimin e të dhënave të detyrueshme sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të punës dhe atij të statistikave sipas nenit 59 me sipër si dhe të miratojë procedurën e lëshimit të Numrit Unik të Identifikimit të Subjektit.
3. Ministri me propozim të Titullarit të QKR përcakton formën dhe

documents. In such cases they are not subject to the administrative fine

12. Subjects that re/register according to this article are provided by NRC with the relevant certificates according to article 62 of this law at the moment they apply for any registration. Until that moment, the certificate of registration with the tax authorities shall be valid.

Article 76

Regulations for the Application of the Law

1. The Council of Ministers shall approve the detailed procedures of acceptance, examination, approval or refusal of the application and publication for registration, cancellation of registered subjects, well as the procedure of correction of errors in registration according to the legislation in force.
2. The Council of Ministers is in charge of approving detailed procedures for the declaration, processing and exchange of compulsory data according to laws on tax, social and health insurance, labor inspection and statistics, according to the relevant forms stipulated in Article 59 above, and for the issuance of the NUIS.
3. The Minister, upon proposal of the Director of NRC, approves the format and content of documents issued by NRC, and format and

përmbajtjen e dokumenteve që lëshohen nga QKR dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer.

4. Ngarkohet Ministri të miratojë procedurat e detajuara për mbrojtjen dhe sigurinë e bazës së të dhënave elektronike të Regjistrisë.
5. Këshilli i Ministrave dhe ministrat e ngarkuar sipas këtij ligji për nxjerrjen e akteve nënligjore plotësojnë këtë detyrim brenda një afati prej 2 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 77
Fillimi i Efekteve

1. Pjesët e këtij ligji që përcaktojnë qëllimin, organizimin dhe funksionimin e QKR shtrijnë efektet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. QKR fillon regjistrimin e subjekteve në përputhje me këtë ligj brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi e tij por jo më vonë se 01.09.2007.
3. Në momentin e fillimit të regjistrimit QKR do të ketë jo më pak se 29 sportele *on-line* në njesitë e qeverisjes vendore. Numri i sporteleve *on-line* do të pakten dyfishohet deri më 1. Korrik 2008.
4. Dispozitat e këtij ligji që i referohen komunikimit, aplikimit elektronik dhe legjislacionit mbi dokumentet elektronik nuk zbatohen për sa kohë nuk është miratuar legjislacioni përkatës.

Neni 78

contents of response for action taken in the registers.

4. The Minister is in charge of approving detailed procedures for backup and protection of electronic database.
5. The Council of Ministers and the ministers in charge of issuing regulations, in accordance with this Law, fulfill this duty within 2 month from the entry into force of this law.

Article 77
Commencement of the effects

1. Parts of this law that define the scope, organization and functioning of NRC and the principles of registration are applicable immediately after the entry into force of this Law.
2. NRC begins the registration of the Subjects in accordance with this Law, within 5 months from its entry into force, but in any case, not later than 1 September 2007.
3. On the starting of its operation NRC will have not less than 29 on-line service windows at local government units. The number of the on-line service windows shall be at least doubled by 31 July 2008.
4. The provisions of the present Law referring to on-line application and communication as well as the provisions related to laws on electronic documents are not applicable until the respective law is in force.

Ndryshime dhe shfuqizime

1. Ne çdo ligj ose akt nënligjor ne fuqi ku përmendet emri gjykate për qëllime të regjistrimit të subjekteve të këtij ligji, do të zëvendësohet me QKR..
2. Ligji nr. 7667, date 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare” si dhe cdo dispozite tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

**Neni 79
Hyrja në Fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**Article 78
Amendments and repeal s**

1. Where mention is made of the name “court” for the purpose of registration of the subject of this Law, it will be replaced by “NRC”.
2. Law no. 7667, dated 28.1.1993 “For the commercial register and formalities to be followed by commercial companies” together with any other provision contrary to this law is repealed.

**Article 79
Entry into force**

This law enters into force 15 days after its publication in the “Official Journal”.